



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. Prot. 330/_____

Data 15.02.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**F.V pajisje mjekësore dhe mobilimi për qendrat shëndetësore të rikonstruara” –
Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara
- me afat 24 muaj me fond limit/vlerë e pritshme e kontratave prej 31,437,346.63 (tridhjetë
e një milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzetë e gjashtë.63) Lekë pa TVSH.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodet CPV: **Pajisje Mjekesore- 33100000-1**

Artikuj Mobilimi- 39516000-2

**VLERA E FONDIT LIMIT: 31,437,346.63 (tridhjetë e një milion e katërqind e tridhjetë e
shtatë mijë e treqind e dyzetë e gjashtë.63) Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** ka hartuar
procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për
kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Sipas Kritereve të Përgjithshme të kualifikimit. (nuk është e aplikueshëm)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

.....
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit). (nuk është e aplikueshëm)

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar, përvërtetim për xhiron vjetore për tre vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 %** e vlerës së fondit limit të kesaj procedure prokurimi.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b, 43 pika 3 dhe 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore **brenda dates 31 mars të vitit pasardhës**,*

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ... *(shëno bazën ligjore)*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **(nuk është i aplikueshëm)**

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, _____

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese). **(nuk është i aplikueshëm)***

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 20 %** të vlerës së fondit të limitit të kesaj procedure prokurimi.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **sa 20%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është e perputhshme me përcaktimet e RRPP nëni 40 pika 4: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të

kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Eshtë kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **sa** 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

3. Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën 2 të DST).

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur siguri që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

4. Ofertuesi duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001 ose ekuivalent, ”Per Sistemin e menaxhimit të cilësive”, të leshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, për tregtim dhe/ose prodhim të mobiljeve, për artikujt e mobilimit të ofertuar.

Në rastin kur ofertuesi nuk është prodhues, duhet të paraqesë edhe Certifikatë ISO 9001 ose ekuivalent për prodhuesin e deklaruar të pajisjeve të mobilimit të ofertuar, të leshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikatat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë, në gjuhën shqip ose të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës.

Kerkesat jane vendosur edhe per prodhuesit, duke patur parasysh prodhimin e mallrave te kerkuar ne perputhje me standartet e cilesise.

5. Operatori ekonomik ne lidhje me artikujt e mobilimit objekt prokurimi dhe/ose lëndët e para të prodhimit të artikujve objekt prokurimi te percaktuar shtojcën 6 Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi, qe do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i autorizuar sipas tabelës nr 1

- Në rast se OE pjesmarrës është tregtues\importues i mallrave objekt prokurimi plotësojë të dhënat sipas tabelës nr 1

Tabela 1

<u>Nr.</u>	<u>Emertimi i produktit</u>	<u>Vendi i origjinës</u>	<u>Certifikatë konformiteti ose cilësie CE(kur është e aplikueshme)/ose ekuivalent</u>
<u>1</u>			
<u>2</u>			
<u>Etj.</u>			

- në rast se OE pjesmarrëse është përpunues i mallrave objekt prokurimi plotësojë të dhënat sipas tabelës nr 2

Tabela 2

<u>Nr.</u>	<u>Emertimi i produktit (Lënda e parë)</u>	<u>Vendi i origjinës</u>	<u>Certifikatë konformiteti ose cilësie CE(kur është e aplikueshme)/ose ekuivalent</u>
<u>1</u>			
<u>2</u>			
<u>Etj.</u>			

Shënim 5.1:

Në rast se operatori edhe tregton edhe përpunon mallrat objekt prokurimi të plotësoj tabelat për secilin artikull qe përpunon dhe/ose tregton.

Shënim 5.2: Kur OE pjesmarrëse është përpunues i mallrave objekt prokurimi, në momentin e dorëzimit të mallit, ai duhet të dorëzojë certifikatat përkatëse të konformitetit për artikujt e ofruar (kur është e aplikueshme).

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.**

Shënim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose

palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standarteve apo certifikimeve CE/ ose ekuivalent - lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

6. Ofertuesi duhet të paraqesë Certifikatë ISO 13485:2016 ose ekuivalent, ”Per Sistemin e menaxhimin te cilesise per pajisjet mjeksore”, e vlefshme, për prodhuesit e artikujve **Nr. 4 dhe Nr. 6.** Certifikatat të jenë të leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, brenda afatit të vlefshmerisë, të përkthyer dhe të noterizuara.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me pikën 6/c të nenit 40 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” lidhur me dëshmitë për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione te autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike si dhe rekomandimit të APP Nr. 7998 Prot., datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbimi”. Ky certifikim garanton kapacitetin e prodhuesit për garantimin e sigurisë dhe cilësisë e produktit për procedurën e vlerësimit të konformitetit, në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” (nenit 17 dhe 18).

Bazuar ne Ligjin 89/2014 "Per pajisjet mjekesore", artikujt Shtrat vizite dhe Stative serumi jane pajisje mjekesore dhe si te tilla duhet te mbajne markimin CE sipas ligjit te sipercituar.

Objekti i prokurimit eshte mobilim per qendra shendetesore te cilat jane struktura te ofrimit te sherbimit shendetesor per pacientet.

Artikujt shtrat pacienti dhe Stative serumi, ndryshe nga artikujt e tjere sherbejne per perkujdesjen dhe trajtimin e pacienteve dhe per kete arsye duhet te jene te sigurta dhe te pajisuara me certifikimet e pajisjeve mjekesore.

7. Operatori ekonomik duhet te paraqese Çertifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, (të përditësuar), per artikujt Nr. 4- shtrat vizitash dhe Nr. 6 – stativ serumi (pajisje mjeksore), të përkthyer dhe të noterizuar ose certifikate FDA, te perkthyer dhe te noterizuar.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 3 dhe 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione te autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Certifikimi CE i këtyre materialeve është obligator në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” (nenit 17 dhe 18) si dhe rekomandimit të APP Nr. 7998

Prot., datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbimi”.

Bazuar ne Ligjin 89/2014 "Per pajisjet mjekesore", artikujt Shtrat vizite dhe Stative serumi jane pajisje mjekesore dhe si te tilla duhet te mbajne markimin CE sipas ligjit te sipercituar.

Objekti i prokurimit eshte mobilim per qendra shendetesore te cilat jane struktura te ofrimit te sherbimit shendetesor per pacientet.

Artikujt shtrat pacienti dhe Stative serumi, ndryshe nga artikujt e tjere sherbejne per perkujdesjen dhe trajtimin e pacienteve dhe per kete arsye duhet te jene te sigurta dhe te pajisuara me certifikimet e pajisjeve mjekesore.

8. Ne rastin kur nuk eshte prodhues, Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të perkthyer dhe te noterizuar)

Argumentim: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objekt prokurimi.

9. Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. **Në katalogë, duhet të shënohet sipas numrit të artikullit ne Shtojcën 2. Listat e Çmimeve të artikujve dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar.** (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe)

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me piken 6/b të nenit 40 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknike, me qëllim verifikimin e plotesimit te specifikimeve teknike.

10. Duhet te paraqitet vetëdeklaratë:

- Per furnizimin sipas kerkeses se AK, me pajisje te reja, sipas prodhuesit te deklaruar ne oferte.
- Për përmbushjen e afatit të garancisë sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të DST
- që merr persiper të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në vendin e dorëzimit.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.

11. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallit, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose qiramarrjen, si më poshtë:

➤ Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

a) Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit;

c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;

e) Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton).

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i **ndryshuar**, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,* si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës.

12. Operatori ekonomik, në rast se është prodhues i mobiljeve të drurit:

a. Duhet të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) punonjes, nga të cilët të paktën 1 (një) punonjes, duhet të jete i punësuar si Inxhinier Druri/Mobiljesh i pajisur me kontrate të vlefshme, i përfshirë në listepagese. Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore;
- Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën Dhjetor 2022.
- Diplomë dhe kontratë pune e vlefshme e punonjësit Inxhinier Druri/ Mobiljesh.

Në këtë kontekst, si Inxhinier Druri/Mobiljesh, (në qëllim të vendosjes së kriterit nga AK) kuptohet dhe është ekuivalent Inxhinier Përpunim Druri / Dizajni i Mobiljeve dhe Interierit, por nuk konsiderohet në përmbushje të kriterit Inxhinieri pyjor.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,* si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.**

b. Duhet të jete i certifikuar për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë dhe për sistemin e menaxhimit të mjedisit. Për këto të paraqese:

- a) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme) /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën **ISO 45001:2018**, për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe të sigurisë në punë (e vlefshme) /ose ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës.

Kriteri vendoset për rastin kur OE është prodhues vendor, si një kërkesë e shtuar për garantimin e zbatimit të kontratës në cilësinë dhe në afatin e kërkuar nga AK.

Certifikatat për menaxhimin e sistemit të sigurisë në punë dhe menaxhimin e mjedisit nga këto OE, kanë lidhje me kërkesat për zbatimin e standardeve, dhe janë vendosur në përputhje me rekomandimin e APP nr. 3341/1 datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim në DT të procedurave të prokurimit”.

Kerkesa per numrin minimal te punonjesve eshte percaktuar duke patur parasysh sasine mesatare te pajisjeve te nevojshme per cdo QSH, afatin e percaktuar per levrimin e kontratave bazuar ne MK, , e lidhur kjo me kohen e perfundimit te rikonstruksionit te QSH dhe venien e menjehereshme te tyre ne funksionim.

Kerkesa per nje Inxhinier Druri/Mobiljesh eshte e lidhur ngushtesisht me realizimin e objektit te prokurimit.

13. Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se nuk është prodhues i mobiljeve të drurit duhet të ketë të punësuar për muajin Dhjetor 2022, një staf punonjësish prej minimalisht 5 persona. Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore;
- Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për muajin Dhjetor 2022.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,* si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.**

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarrës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike:

Nr.	Artikulli	Specifikimet teknike	Njesia e matjes
-----	-----------	----------------------	-----------------

1	Karrige pune per mjekun	Karrige mjeku me krahë, e lëvizshme, me 5 rrota me bazën plastike të zezë, pjesa mbështetëse imiton shpinën dhe ka fleksibilitetin e duhur për tu mbështetur, komforte, e veshur me copë ose lëkurë me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lashëm, me regjstrues lartësie për të ngritur dhe ulur karrigen. (pesha rreth 12kg, lartësia e shpinës jo më pak se 90 dhe jo me shume se 107cm, lartësia e ndenjësës jo më pak se 45 dhe jo me shume se 52cm, thellësia jo më e vogël se 44cm, gjerësia jo më e vogël se 58cm.)	cope
2	Karrige per pacientin në dhomën e mjekut/ stafin infermieror/personel	Karrige komferte, e kornizuar me 4 këmbë metalike të palëvizshme. (pesha 7kg, lartësia e shpinës jo më e vogël se 82cm, lartësia e ndenjësës jo më e vogël se 45cm, thellësia rreth 43cm, gjerësia rreth 53cm).Materiali rezistent ndaj disinfektimit dhe i lashem	cope
3	Tavolinë pune për mjekun/infermierin	Tavolinë pune mjeku, me suprinë me material laminant të plastifikuar, me përmasa jo më të vogla se (120*80*h75 cm), me kënde të rrumbullakosura dhe të veshura me material të plastifikuar, me 4 (katër) këmbë material inoksi, këmbët mat tub oval, në njërin anë të tavolinës (të majtë ose të djathtë) janë të inkuorporuar 2 sirtarë me përmasa jo më të vogla se (40*40*h30cm) secili sirtar, me doreza metalike ngjyrë gri mat. Materiali i tavolinës duhet të jetë i fortë, ti rezistojë kohës dhe lagështirës, dhe të jetë i pastrueshëm.	cope

4	Shtrat vizitash	Shtrat vizitash me skelet inoksi me permasa jo me te vogla se (180*57* h73cm, pesha min 100kg), me dy pjesë: pjesa shpinore e cila ka mundësi të lëvizë në disa pozicione, e paisur me dyshek të veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lashëm, me permasa jo me te vogla se (130*61* h5.5cm) e pjesës së fiksuar, dhe me permasa jo me te vogla se (50*61*h5.5cm) e pjeses se shpinores, e kornizuar, e pajisur me 4 këmbë inoksi, e pajisur në fund të shtratit me mbajtësen e letrës rulo universal.	cope
5	Shkalle ndihmese per shtratin e vizites	Shkallë ndihmëse e përbërë nga dy shkallë, e kornizuar me këmbë tubulare ngjyrë gri mat, platforma e shkallës me material plastik i rezistueshëm jo i rrëshqitshëm, shkeljet te jenë me permasa: jo më të vogel se 40cm gjatesi*51cm gjeresi; me lartesi nga toka: shkalla e pare 25cm dhe shkalla e dyte 50cm.	cope
6	Stativa serumi	Stativa serumi me strukturë inoksi, me lartësi maksimale rreth 2m, të rregjistrueshme/të rregullueshme, me bazament plastikë të zezë me 5 këmbë me rrota, dhe me 4 grepa për varjen e mbajtëses së serumit.	cope
7	Dollap mjeku per dhome konsulte	Dollap mjeku për dhomë konsulte me permasa jo me e vogël se (80*50*h200) me dy hapësira. Njera per te varur rroba dhe tjetra raft. Me kapak gjatësor të kornizuar me element metalikë me kënde të rrumbullakosura, materiali laminat me trashësi 2.5 cm, këmbët e dollapit të mbulura (jo të dukshme). Brenda kanatit duhet te jene te inkastruar aksesoret per vendosje kremastari etj.	cope

8	Raft për dokumentacion	Element gjysëm i hapur për arkivim dokumentacioni jo më të vogël se (80*50*h200 cm) me material laminant trashësi jo më të vogël se 2.5 cm, me bordure të plastifikuar, me kanata (h 76.4cm) në pjesën e poshtme. I gjithë rafti duhet të jetë i ndarë vertikalisht në 5 hapsira. Këmbët duhet të jenë metalike me lartësi jo më të vogël se 10cm. Ngjyra gri metalizatto	cope
9	Karrige per pritje holli e thjeshte	Set Karrige Vizitorësh, të përbëra nga 3 karrige të lidhura bashkë, ku ndenjëset janë të veshura me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lashëm dhe shpinorja është e përbërë nga një material të fortë (laminant).	sete
10	Perde me mekanizem	Perde-Roler me mekanizëm në anë, për uljen dhe ngritjen e saj, për dritare. Copa të jetë me material cilësor jo transparent dhe antibakterial.	m2
11	Reception me një post (receptioni me një post ka përmasa 140*70*h75)	Reception për një post, me dy nivele, jo më të vogël se (140*70*h75cm) me lartësi të nivelit të dytë jo më të vogël se 110 cm, me gjerësi të syprinës jo më të vogël se 25 cm, i cili do të jetë në anën e vizitorit. Mobilja duhet të jetë e hapur nga ana e operatorit për pozicionim e këmbëve. Materiali do të jetë laminant me trashësi jo më të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dytë duhet të jetë laminat me bordure të plastifikuar dhe duhet të kapet me të parën. Në brendësi, receptioni do të ketë 1 komodinë me nga 3 sirtarë, me përmasa jo më të vogla se (45*45*h65 cm) me material laminat me trashësi jo më të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.	cope

12	<p>Reception për tre poste, me dy nivele (receptioni me tre poste ka përmasa 390*60*h75)</p>	<p>Reception për tre poste, me dy nivele, jo me të vogël se (390*60* h75cm) me lartësi te nivelit te dyte jo me të vogël se 110 cm, me gjerësi jo me të vogël se 25 cm, i cili do te jete ne anen e vizitorit . Mobilja duhet te jete e hapur nga ana e operatorit per pozicionim e kembeve. Materiali do te jete laminant me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dyte duhet të jetë me material laminat me bordure te plastifikuar. Në brendësi, receptioni do të ketë 3 komoda me nga 3 sirtarë, me përmasa jo më të vogla se (45*45*h65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.</p>	cope
13	<p>Rafte për ilaçe dhe pajime të vogla mjekësore (me përmasa 40*80*h84cm)</p>	<p>Materiali i përdorur është MDF i melaminuar elementet vertikale dhe horizontale janë 12 mm, mobilja e sipërme do të fiksohet me prixhionere në mur me dy kanate me doreza inoksi. Kapakët do të trajtohen me bordime të plastifikuara. Bangoja do të jetë e plastifikuar ngjyrë gri metalizato. Pjesa e poshtme do të ketë në horizontalitet dy ndarje me nga katër rafte në secilën anë ku secili raft të hapet me dorezë inoksi. Ngjyra e kapakëve e bardhë perlë.</p>	cope

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sasia, Destinacioni dhe Grafiku i Levrimit:

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Artikulli	Specifikimet teknike	Njesia e matjes	SASIA TOTALE
1	Karrige pune per mjekun	Karrige mjeku me krahë, e lëvizshme, me 5 rrota me bazën plastike të zezë, pjesa mbështetëse imiton shpinën dhe ka fleksibilitetin e duhur për tu mbështetur, komforte, e veshur me copë ose lëkurë me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtueshëm nga uji dhe të lashëm, me rregjstrues lartësie për të ngritur dhe ulur karrigen. (pesha rreth 12kg, lartësia e shpinës jo më pak se 90 dhe jo me shume se 107cm, lartësia e ndenjësës jo më pak se 45 dhe jo me shume se 52cm, thellësia jo më e vogël se 44cm, gjerësia jo më e vogël se 58cm.)	cope	143
2	Karrige per pacientin në dhomën e mjekut/ stafin infermieror/personel	Karrige komforte, e kornizuar me 4 këmbë metalike të palëvizshme. (pesha 7kg, lartësia e shpinës jo më e vogël se 82cm, lartësia e ndenjësës jo më e vogël se 45cm, thellësia rreth 43cm, gjerësia rreth 53cm).Materiali rezistent ndaj disinfektimit dhe i lashem	cope	647

3	Tavolinë pune për mjekun/infermierin	Tavolinë pune mjeku, me suprinë me material laminant të plastifikuar, me përmasa jo më të vogla se (120*80*h75 cm), me kënde të rrumbullakosura dhe të veshura me material të plastifikuar, me 4 (katër) këmbë material inoksi, këmbët mat tub oval, në njërën anë të tavolinës (të majtë ose të djathtë) janë të inkuorporuar 2 sirtarë me përmasa jo më të vogla se (40*40*h30cm) secili sirtar, me doreza metalike ngjyrë gri mat. Materiali i tavolinës duhet të jetë i fortë, ti rezistojë kohës dhe lagështirës, dhe të jetë i pastrueshëm.	cope	300
4	<u>Shtrat vizitash</u>	Shtrat vizitash me skelet inoksi me përmasa jo më të vogla se (180*57* h73cm, pesha min 100kg), me dy pjesë: pjesa shpinore e cila ka mundësi të lëvizë në disa pozicione, e paisur me dyshek të veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lashëm, me përmasa jo më të vogla se (130*61* h5.5cm) e pjesës së fiksuar, dhe me përmasa jo më të vogla se (50*61*h5.5cm) e pjesës së shpinores, e kornizuar, e pajisur me 4 këmbë inoksi, e pajisur në fund të shtratit me mbajtësen e letrës rulo universal.	cope	227
5	<u>Shkalle ndihmese per shtratin e vizites</u>	Shkallë ndihmëse e përbërë nga dy shkallë, e kornizuar me këmbë tubulare ngjyrë gri mat, platforma e shkallës me material plastik i rezistueshëm jo i rrëshqitshëm, shkeljet të jenë me përmasa: jo më të vogël se 40cm gjatësi*51cm gjerësi; me lartësi nga toka: shkalla e parë 25cm dhe shkalla e dytë 50cm.	cope	234
6	<u>Stativa serumi</u>	Stativa serumi me strukturë inoksi, me lartësi maksimale rreth 2m, të rregjistrueshme/të rregullueshme, me bazament plastik të zezë me 5 këmbë me rrota, dhe me 4 grepa për varjen e mbajtëses së serumit.	cope	183

7	Dollap mjeku per dhome konsulte	Dollap mjeku për dhomë konsulte me permasa jo me e vogël se (80*50*h200) me dy hapësira. Njera per te varur rroba dhe tjetra raft. Me kapak gjatësor të kornizuar me element metalikë me kënde të rrumbullakosura, materiali laminat me trashësi 2.5 cm, këmbët e dollapit të mbulura (jo të dukshme). Brenda kanatit duhet te jene te inkastruar aksesoret per vendosje kremastari etj.	cope	206
8	Raft për dokumentacion	Elment gjysëm i hapur për arkivim dokumentacioni jo më të vogël se (80*50*h200 cm) me material laminant trashësi jo më të vogël se 2.5 cm, me bordure të plastifikuar, me kanata (h 76.4cm) në pjesën e poshtme. I gjithë rafti duhet të jetë i ndarë vertikalisht në 5 hapsira. Këmbët duhet të jenë metalike me lartësi jo më të vogël se 10cm. Ngjyra gri metalizatto	cope	372
9	Karrige per pritje holli e thjeshte	Set Karrige Vizitorësh, të përbëra nga 3 karrige të lidhura bashkë, ku ndenjëset janë të veshura me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lashëm dhe shpinorja është e përbërë nga një material të fortë (laminant).	sete	151
10	Perde me mekanizem	Perde-Roler me mekanizëm në anë, për uljen dhe ngritjen e saj, për dritare. Copa të jetë me material cilësor jo transparent dhe antibakterial.	m2	1,358.50
11	Reception me një post (receptioni me një post ka përmasa 140*70*h75)	Reception për një post, me dy nivele, jo me të vogël se (140*70*h75cm) me lartësi të nivelit të dytë jo më të vogël se 110 cm, me gjerësi të syprinës jo më të vogël se 25 cm, i cili do të jetë në anën e vizitorit. Mobilja duhet të jetë e hapur nga ana e operatorit për pozicionim e këmbëve. Materiali do të jetë laminant me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dytë duhet të jetë laminat me bordure të plastifikuar dhe duhet të kapet me të parën. Në brendësi, receptioni do të ketë 1 komodinë me nga 3 sirtarë, me përmasa jo me të vogla se (45*45*h65 cm) me material laminat me trashësi jo më të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.	cope	55

12	Reception për tre poste, me dy nivele (receptionsi me tre poste ka përmasa 390*60*h75)	Reception për tre poste, me dy nivele, jo me të vogël se (390*60* h75cm) me lartësi te nivelit te dyte jo me të vogël se 110 cm, me gjerësi jo me të vogël se 25 cm, i cili do te jete ne anen e vizitorit . Mobilja duhet te jete e hapur nga ana e operatorit per pozicionim e kembeve. Materiali do te jete laminant me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dyte duhet të jetë me material laminat me bordure te plastifikuar. Në brendësi, receptioni do të ketë 3 komodina me nga 3 sirtarë, me përmasa jo më të vogla se (45*45*h65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.	cope	4
13	Rafte për ilaçe dhe pajime të vogla mjekësore (me përmasa 40*80*h84cm)	Materiali i përdorur është MDF i melaminuar elementet vertikale dhe horizontale janë 12 mm, mobilja e sipërme do të fiksohet me prixhionere në mur me dy kanate me doreza inoksi. Kapakët do të trajtohen me bordime të plastifikuara. Bangoja do të jetë e plastifikuar ngjyrë gri metalizato. Pjesa e poshtme do të ketë në horizontalitet dy ndarje me nga katër rafte në secilën anë ku secili raft të hapet me dorezë inoksi. Ngjyra e kapakëve e bardhë perlë.	cope	195

Afatet e lëvrim: sipas kërkesave të AK, referuar materialit të grupit të punës; Duke u nisur nga fakti se qendrat shëndetësore objekt mobilimi, mbarojnë së rikonstruktuar në kohë të ndryshme si dhe bazuar në kontratat e ngjashme të realizuara, afati i lëvrim të mallit do jetë brenda 25 (njëzetë e pesë) ditëve nga data e lidhjes së kontratës mes palëve.

Destinacioni:

Nr	NJVKSH	Qendra Shendetesore
1	Njvksh Tirane	Frutikulture
2		Farkë e Madhe
3		Paskuqan 2
4		Bathore Lagja 6
5		Pika e QSH Nr. 8 Nr 2
6		Prush
7	Njvksh Kavaje	Bago
8		Shtodher
9		Vile Bashtove

10		QSH Luz i Vogël
11		Ambulanca Vorrozen
12	Njvksh Shkoder	F.Ana e Malit
13		F/Daje
14		F/Velipojë
15		Ambulanca Lagjia - M.Aliman
16	Njvksh M. Madhe	QSH Rec
17		F/Dedaj
18	Njvksh Puke	Gjegjan
19	Njvksh Tropoje	Aste QSH Tropojë
20		QSH Lekbibaj
21	Njvksh Has	Vllahen
22	Njvksh Kukes	QSH Bicaj
23	Njvksh Lezhe	Rraboshtë
24		Manati
25	Njvksh Kurbin	Q/Laç
26		QSH Fush-Kuqe
27	Njvksh Mirdite	Q/Reps
28		QSH /Rubik
29	NJVKSH Gjirokaster	Erind
30		Andon Poçi
31		QSH Pogon
32		Picar
33		QSH Libohove
34	NJVKSH Tepelene	Vasjar
35		Cerrilë
36	NJVKSH Permet	Fshat Këlcyrë
37		Kutal
38		Pacomit
39		QSH Ballaban
40	Njvksh Berat	Roshnik (QSH)
41		Ambulanca Banaj
42	Njvksh Kucove	Lagjia -L I. Prifti
43	NJVKSH KORÇË	Kamenicë
44		QSH Maliq
45		Ambulance Plase
46	NJVKSH DEVOLL	Pilur
47		Ambulanca Trestenik
48	NJVKSH POGRADEC	F/Proptisht
49		F/Udenisht
50		QSH Barmash

51	NJVKSH KOLONJË	Amb. Qinam
52	NJVKSH Vlore	Hoshtimë
53		F/Armen
54		Bishan Amb.
55		Lagjia "28 Nentori"
56		QSH Orikum
57	NJVKSH Delvine	Vllahat
58		Vanë
59		Krane
60		QSH Blerimas
61	NJVKSH Sarande	Xarrë
62		Borsh
63		QSH Vrinë
64	NJVKSH ELBASAN	Xibrakë Amb.
65		Lagjia - Dyli Haxhire
66		F/Labinot-Fushë (katund)
67		Lagjia - Br. 17 S
68		Lleshan
69	NJVKSH LIBRAZHD	Rashtan (Amb.)
70	NJVKSH PEQIN	QSH Përparim
71	NJVKSH GRAMSH	F/Kukur
72		Mashan Amb.
73	Njvksh Durres	Adriatik
74		Kodër Bizë
75		Rrushkull
76		Gjuricaj e sipërme
77		Ambulanca Arapaj 2
78		QSH Nr. 2 Lagjia-nr.5, 6 , 7
79	Njvksh Kruje	Budull
80		Bilaj
81		Qerek
82		Kurcaj